



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4/287

Datë: 29/12/2021

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 22 dhe 23, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në vazhdimin e mbledhjes së datës 09.12.2021, të mbajtur më datë 15.12.2021, merr këtë:

**V E N D I M**

***Për procedurën e realizimit të shkëmbimeve afatshkurtra të stafit akademik gjatë ofrimit të ciklit të ligjëratave një javore duke filluar nga viti akademik 2021/22***

1. Në kuadër të ciklit të kufizuar të ligjëratave, kompensohen shpenzimet e realizimit të ciklit të shkurtër të ligjëratave nëse mësimdhënësi realizon së paku 2 e më së shumti 6 orë ligjërata.
2. Në rastin e realizimit të ligjëratave, mësimdhënësit përpos kompensimit të orëve sipas nenit 14 të Rregullores për të ardhura personale nr. 2/543 i kompensohen edhe shpenzimet tjera shoqëruese (udhëtim, akomodim, ushqim) si vijon:
  - a) Për 2-6 orë ligjërata brenda ditës, shpenzimet shoqëruese për 3 ditë
  - b) Për 2-3 orë ligjërata brenda ditës, shpenzimet shoqëruese për 3 ditë
  - c) Për 4-5 orë ligjërata brenda dy ditëve, shpenzimet shoqëruese për 4 ditë
  - d) Për 6 orë ligjërata brenda tri ditëve, shpenzimet shoqëruese për 5 ditë
3. Kërkesa për realizimin e qëndrimit në universitetin pritës përkatësisht shpenzimeve të qëndrimit në Universitetin e Prishtinës parashtrohet pranë Departamentit/Degës përkatëse dhe shqyrtohet nga Këshilli i Fakultetit
4. Qëndrimi lejohet vetëm në rast të aprovimit nga ana e Këshillit të Fakultetit.
5. Të drejtë për t'u përfshirë në shkëmbime afatshkurtra kanë mësimdhënësit në marrëdhënie të rregullt pune në universitetin përkatës me titull akademik së paku Prof. Ass. Dr.
6. Mësimdhënësit i lejohet qëndrimi për më shumë se një (1) herë në universitetin e njëjtë vetëm nëse nuk ka të interesuar tjerë për realizimin e qëndrimit në universitetin përkatës.
7. Mësimdhënësit të Universitetit të Prishtinës nuk i lejohet më shumë se një (1) qëndrim brenda vitit pavarësisht nëse kërkesa shtrohet për qëndrim në universitetin e njëjtë apo në universitete të ndryshme.
8. Mësimdhënësit të universitetit partner nuk i lejohet më shumë se një (1) qëndrim brenda vitit në Universitetin e Prishtinës.
9. Lidhur me aktivitetet e realizuara, mësimdhënësi i Universitetit të Prishtinës dorëzon raportin me shkrim pranë Këshillit të Fakultetit (brenda 2 javësh) përkatësisht pranë zyrës së Financave të UP-së (në momentin e dorëzimit të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të qëndrimit).

10. Kërkesa për rimbursimin e shpenzimeve të qëndrimit në universitetin partner parashtrohet nga Mësimdhënësit pranë zyrës së Financave të UP-së, së bashku me dokumentacionin përkatës (listën e studentëve të pranishëm, dëshmitë e shpenzimeve, vendimin e Fakultetit për aprovimin e qëndrimit, raportin që qëndrimit)
11. Kërkesa për rimbursimin e shpenzimeve të qëndrimit të mësimdhënësit nga universiteti partner në UP parashtrohet nga ana e shefit të departamentit përkatës të UP-së, pranë zyrës së Financave të UP-së, së bashku me dokumentacionin përkatës (listën e studentëve të pranishëm, dëshmitë e shpenzimeve, vendimin e Fakultetit për aprovimin e qëndrimit).

### Arsyetim

Këshilli Drejtues i UP-së në vazhdimin e mbledhjes së datës 09.12.2021 të mbajtur me datë 15.12.2021, me qëllim të sqarimit më të detajuar të nenit 14 të Rregullores për të ardhura personale nr. 2/543, dt.22.10.2021 dhe shmangies së çfarëdo interpretimi ndryshe, që ndërlihet me procedurën e realizimit të shkëmbimeve afatshkurtra të stafit akademik- profesorëve vizitorë gjatë ofrimit të ciklit të ligjëratave një javore, nga universitetet e vendeve të rajonit që kufizohen me Republikën e Kosovës, përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së
2. Rektorit të UP-së,
3. Dekanëve të njësive akademike,
4. Sekretarëve të njësive akademike,
5. Shërbimit të financave të UP-së dhe
6. Administratorit të ueb-faqes së UP-së.



Këshilli Drejtues i UP-së  
Dr. Arbëresha Nela Turjaka, kryesuese